



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 390/1 Prot.

Tiranë, më 01 / 03 / 2021

V E N D I M

Nr. 37, Datë 01 / 03 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 135, datë 16.11.2020, të paraqitur nga P.K kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike¹”, “gjendjes arsimore²” dhe “çdo shkak tjetër³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me e-mail-in datë 23.11.2020, ankuesi në mes të tjerash informon se: *“P.K me kërkesën nr. 35, datë 30.01.2018 i është drejtuar DRSSH Dibër, në të cilën ka kërkuar t’i lidhet pension si punonjës i minierave nëntokë. DRSSH Dibër me shkresën nr. 155, datë 01.03.2018 ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyen se nuk plotësonte vitet e punës nëntokë (duhen 12 vjet e 6 muaj). Në vijim ankuesi ka kundërshtuar përgjigjen e DRSSH Dibër duke e ankuar në Komisionin Rajonal të Ankimit të DRSSH Dibër, të cilët me Vendimin nr. 103, datë 14.06.2019 kanë rrëzuar kërkesën e ankuesit. Më pas P.K i është drejtuar me ankesë Komisionit Qëndror të Ankimit pranë ISSH-së i cili me Vendimin nr. 1612, datë 18.11.2019 ka lënë në fuqi Vendimin nr. 103, datë 14.06.2019 të KRA pranë DRSSH Dibër.*

¹ Referuar Vërtetimit nr. 1043, datë 22.12.2017 të DRSSH Dibër, P.K për periudhën shtator 2016 deri në tetor 2017 ka pasur pagën 28.802 lekë në muaj.

² Referuar Librezës së Punës me Nr. i regjistrit themeltar 8/F1999/1, datë 13.10.1991, ankuesi ka arsimin 8-vjeçar.

³ Pa përcaktuar një cilësi personale apo shkak.

Ankuesi nuk ka rënë dakord me vendimin e Komisionit Qendror të Ankimit dhe i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me Vendimit Nr. 1370, datë 06.07.2020 ka vendosur shfuqizimin e shkresës nr. 155, datë 01.03.2018 të DRSSH Dibër, shfuqizimin e Vendimit nr. 103, datë 14.06.2019 të KRA pranë DRSSH Dibër, shfuqizimin e Vendimit nr. 1612, datë 18.11.2019 të KQA pranë ISSH-së dhe ka vendosur detyrimin e DRSSH Dibër dhe ISSH-së që ti lidhin P.K pensionin si punonjës i minierave nëntokë në përputhje me Ligjin 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë”. Ankuesi informon se i është njohur nga DRSSH Dibër, 8 vite e 11 muaj periudhë pune nëntokë dhe bazuar në dokumentacionin që disponon (të njohura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë) ka punuar në Minierën e Kromit Batër dhe në periudhën 10.01.1976 deri më 31.10.1987, periudhë e cila i refuzohet ti njihet nga DRSSH Dibër me argumentin se periudha e punës mbivendoset me periudhën e punës në Kooperativën Bujqësore Derjan. Ankuesi pretendon se po trajtohet në mënyrë diskriminuese nga ana e DRSSH Dibër dhe ISSH-ja për shkak se ka nivel të ulët arsimor (arsim 8-vjeçar) dhe gjendje të vështirë ekonomike, pasi nga data 30.11.2017 deri ditën që ka depozituar kërkesën për pension (datë 30.01.2018) ka qenë i papunë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe lidhjen e pensionit si punonjës i minierave nëntokë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1572/2, datë 26.11.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Dibër dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Shpjegime, nëse ka patur raste të njëjta apo të ngjashme të mosnjohjes së viteve të punësimit si punonjës i minierave nëntokë për shkak se ka mbivendosje të viteve të punësimit me punën në kooperativë dhe për shtetas të tjerë që kanë arsim të mesëm apo të lartë, dhe nëse po, kopje të dokumenteve të këtyre dosjeve.
 - Shpjegime, nëse ka patur raste të njëjta apo të ngjashme të mosnjohjes së viteve të punësimit si punonjës i minierave nëntokë për shkak se ka mbivendosje të viteve të punësimit me punën në kooperativë dhe për shtetas të tjerë që kanë qenë të punësuar deri ditën që kanë bërë kërkesë për caktim pensioni, dhe nëse po, kopje të dokumenteve të këtyre dosjeve.
 - Kopje të kërkesave dhe ankesave të bëra nga P.K dhe përgjigjeve e vendimeve të marra nga DRSSH Dibër, Komisioni Rajonal i Ankimit të DRSSH Dibër dhe Komisionit Qëndror të Ankimit pranë ISSH-së.
 - Kopje të Vendimit Nr. 1370, datë 06.07.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kopje të ankimit nga ana juaj të këtij vendimi në apel (nëse ka).

Me shkresën nr. 6689/1, datë 02.12.2020, DRSSH Dibër dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Me kërkesën nr. 314, datë 13.07.2016, P.K i është drejtuar ALSSH Mat për përfitimin e pensionit, sipas Ligjit 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”. Pas verifikimeve të kryera, DRSSH Dibër, me shkresën nr. 207, datë 18.07.2016, i ka kthyer përgjigje negative P.K, për shkak të mosplotësimit të kushteve të Ligjit 150/2014, në të cilin parashikohet se për të përfituar nga ligji duhet të plotësohen kushtet: - mosha 55 vjeç; - vjetërsia totale 30 vjet nga të cilat 12 vjet e 6 muaj në nëntokë. Në bazë të dokumenteve të dorëzuar nga P.K rezulton se ka 29 vjet e 1 muaj punë, nga të cilat 11 vite e 5 muaj në nëntokë. Gjithashtu, P.K ka aplikuar për përfitim të pensionit me kërkesën nr. 35, datë 30.01.2018. Mbi kërkesën përkatëse DRSSH Dibër ka vlerësuar se ankuesi nuk plotëson kushtet e Ligjit 150/2014, e në rrethana të tilla ka refuzuar kërkimet sipas shkresave, nr. 207, datë 18.07.2016 dhe nr. 155, datë 01.03.2018. P.K nuk ka qenë dakord me përgjigjet dhe i është drejtuar KRA-Dibër. Komisioni Rajonal i Ankimit Dibër me Vendimin nr. 103, datë 14.06.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit. Pas*

kësaj ankuesi i është drejtuar me ankesë Komisionin Qendror të Ankimit pranë ISSH, i cili me Vendimin nr. 1612, datë 18.11.2019 ka vendosur të rrëzojë kërkesën e P.K. Pas marrjes dijeni për vendimin e mësipërm, P.K është drejtuar me padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të mësipërme. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin nr. 1370, datë 06.07.2020 ka vendosur: - Pranimin e kërkesë-padisë. - Shfuqizimin e shkresës/aktit Kthim përgjigje nr. 155, datë 01.03.2018 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër. - Shfuqizimin e Vendimit nr. 103, datë 14.06.2019 të marrë nga Komisioni Rajonal i Ankimit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër. - Shfuqizimin e Vendimit nr.1612, datë 18.11.2019 të marrë nga Komisioni Qendror i Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. - Detyrimin e palës së paditur ti lidhë palës paditëse pension si punonjës i minierave në nëntokë në përputhje me Ligjin 150/2014, nga data e paraqitjes së kërkesës për pension, që nga data 30.01.2018 e në vazhdim. Me këtë vendim gjyqësor Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër nuk ka qenë dakort, ndaj nëpërmjet shkresës nr. 836/9, datë 27.07.2020 “Ankim Civil” i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ku është kërkuar ndryshimi i vendimit dhe rrëzimi i kërkesë padisë së P.K. DRSSH Dibër ka mbajtur të njëjtin qëndrim, si në rastin e P.K, kur një person ka pasur dublime të vjetërsisë në punë edhe në minierë edhe në ish Kooperativë Bujqësore në të cilën është mbajtur qëndrimi në bazë të verifikimeve të kryera në bordero, pasi siç dihet borderotë janë burimi primar i vjetërsisë në punë, pasi në bazë të borderove, plotësohet rregjistri dhe në bazë të rregjistrimit plotësohet librezja e punës. DRSSH Dibër ka pasur dhe një rast të ngjashëm me P.K që ka pasur dublime të vjetërsisë në punë edhe pranë Minierës së Kromit Batër edhe pranë ish Kooperativës Bujqësore Macukull. Ky rast është i paditësit B.S dhe është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, me objekt njohjen e pavërtetësisë së rregjistrimit themeltar nr. x, faqe y, të ish Kooperativës Bujqësore Macukull, përsa i përket viteve të punës 1976-1986 për z. B.S dhe njohjen e vërtetësisë së rregjistrimit themeltar nr. x, faqe y, të Minierës së Kromit Batër përsa i përket viteve të punës nga 1977 deri në 1990, në emër të z. B.S. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, në përfundim të gjyqimit, ka vendosur pranimin e padisë, vendim i cili është ankimuar nga ana e DRSSH Dibër pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Me shkresën nr. 7413/1, datë 14.12.2020, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “P.K ka paraqitur pranë DRSSH Dibër kërkesën nr. 35, datë 30.01.2018, për të përfutur pension në kuptim të Ligjit 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”. Në vijim DRSSH Dibër bazuar në Kapitullin III, pikat 1 dhe 2 të Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve” ka verifikuar periudhat e punës të P.K. Nga verifikimi i bërë në zbatim të dispozitës së mësipërme ka rezultuar se P.K nuk përmbushte kushtet e parashikuara në Ligjin 150/2014. Pas kësaj ankuesi ka vijuar me procedurat e ankimit në Komisionin Rajonal të Ankimit Dibër, në Komisionin Qendror të Ankimit pranë ISSH dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe aktualisht ISSH-ja me shkresën nr. 4383, datë 28.07.2020 ka ankimuar vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe çështja

është në proces shqyrtimi. Lidhur me kërkesën për shpjegime, për raste të ngjashme me P.K, informohet se ISSH në vazhdimësi, nëpërmjet strukturave të saj ndër vite ka bërë kontrollin e përfitimeve të caktuara nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, për të cilat, kur ka konstatuar parregullsi dhe pasaktësi në caktimin e përfitimeve ka bërë rishqyrtimin e tyre, deri në mbylljen e këtyre përfitimeve. Është e rëndësishme t'ju bëjmë me dije se me administrimin e të dhënave në Arkivin Qendror të ISSH-së është bërë i mundur digjitalizimi i të dhënave, si rezultat i të cilit bëhet verifikimi i periudhave të punës së çdo punonjësi, si në ish kooperativat bujqësore (deri në vitin 1991) ashtu dhe në ndërmarrjet shtetërore. Raste të pezullimit të përfitimeve janë ndeshur në disa Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, të cilat administrojnë edhe dokumentacionin e çdo dosje përfitimi që është pezulluar për të njëjtat arsye për të cilat është pezulluar edhe dosja e përfitimit të P.K. Meqënëse ankuesi ka marrë përfitimin pranë DRSSH Dibër, po japim disa të dhëna mbi përfitime të kësaj drejtorie, të cilat janë pezulluar nga ana e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve pranë ISSH-së, pas konstatimeve për parregullsi në caktimin e përfitimeve si më poshtë: Dosja nr. 60, me përfitues K.O; Dosja nr. 141 me përfitues A.M; dhe Dosja nr. 150, me përfitues I.P. Rastet e mësipërme, janë disa nga praktikat e përfitimeve, për të cilat është rekomanduar pezullimi i përfitimit. Çdo Drejtori Rajonale e Sigurimeve Shoqërore që ka në kompetencën e saj përfituesin, të cilit i është rekomanduar për pezullim, përfitimi i caktuar, ka në administrim dokumentacionin e dosjes së përfitimit, e cila është rekomanduar për pezullim nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve pranë ISSH-së, apo është pezulluar nga vetë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, pas verifikimeve të kryera. Në nenin 5, të Ligjit 150/2014, është përcaktuar se personi, i cili ka përfitur pension sipas këtij ligji, nuk ka të drejtë përfitimi të kësteve për periudhën/periudhat, gjatë të cilave ushtron veprimtari ekonomike si i punësuar, i vetëpunësuar apo punëdhënës, me përjashtim kur vetëpunësohet në bujqësi. Bazuar në një dispozitë të tillë, nga ana e ISSH-së, bazuar edhe në marrëveshjet e bashkëpunimit që Instituti ka me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në vazhdimësi është bërë kontrolli i personave të cilët janë përfitues sipas këtij ligji, lidhur me faktin nëse ushtrorjnë veprimtari ekonomike dhe në rastet kur rezultojnë të tillë bëhet pezullimi i përfitimit. Në përfundim rezulton se P.K nuk është diskriminuar nga ISSH-ja, pasi rasti i tij nuk është i veçuar, duke qenë se verifikimi i periudhave të vjetërsisë në punë bëhet në mënyrë sistematike”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim*’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësohte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar⁴ dhe Kodi i Punës, i ndryshuar⁵, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast: DRSSH Dibër dhe ISSH, të cilët duhet të provonin se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme për shkakun e pretenduar prej tij.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe u janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

A. Lidhur me trajtimin e paligjshëm të ankuesit nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Bazuar në vendimin gjyqësor dhe aktet e ankimit të depozituara në dosjen e ankuesit, respektivisht: Vendimin nr. 1370, datë 06.07.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe ankimin nr. 836/9, datë 27.07.2020 të DRSSH Dibër dhe ankimin nr. 4383, datë 28.07.2020 të ISSH pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, rezulton se pretendimi i ankuesit për mosnjohjen e viteve të punës si punonjës që ka punuar në nëntokë nga ana e subjekteve ndaj të cilëve është ankuar, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Komisioneri

⁴Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

⁵Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

vlerëson se ky është një pretendim që do të trajtohet nga organet gjyqësore dhe jo nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

B. Lidhur me trajtimin e pabarabartë të ankuesit nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Ankuesi me kërkesën nr. 35, datë 30.01.2018 i është drejtuar DRSSH Dibër, në të cilën ka kërkuar t'i lidhet pension si punonjës i minierave nëntokë. DRSSH Dibër ka verifikuar periudhat e punës së P.K dhe me shkresën nr. 155, datë 01.03.2018 ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyen se pas verifikimeve të bëra, rezulton se P.K ka 34 vjet e 8 muaj punë nga të cilat 8 vjet e 11 muaj në nëntokë.

P.K ka kundërshtuar përgjigjen e DRSSH Dibër duke e ankuar në Komisionin Rajonal të Ankimit të DRSSH Dibër. KRA i DRSSH Dibër me Vendimin nr. 103, datë 14.06.2019 ka rrëzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se kërkuuesit nuk i është konfirmuar minimumi i viteve të punës të nevojshëm për ti caktuar pension pleqërie sipas Ligjit 150/2014.

Më pas P.K i është drejtuar me ankesë Komisionit Qëndror të Ankimit pranë ISSH-së. KQA e ISSH-së me Vendimin nr. 1612, datë 18.11.2019 ka lënë në fuqi Vendimin nr. 103, datë 14.06.2019 të KRA pranë DRSSH Dibër me arsyetimin se: *“Sipas akt verifikimit të datës 09.02.2018 të DRSSH Dibër, nga verifikimi në bordero të Minierës së Kromit Batër, rezulton se për periudhën 16.03.1976 deri 01.02.1987 nuk i figuron emri. Sipas vërtetimit nr. 897, datë 05.06.2018 të DRSSH Dibër, në regjistrin themeltor nr.1, fq 197 të Kooperativës Bujqësore Derjan, figuron me ditë pune për vitet 1976 – 1986. Kjo periudhë është llogaritur si periudhë sigurimi. Periudha e punës pranë Minierës së Kromit Batër mbivendoset me periudhën e punës në Kooperativën Bujqësore Derjan. Kërkuuesit i konfirmohen vetëm 8 vite dhe 11 muaj periudhë pune nëntokë”*.

Ankuesi nuk ka rënë dakord me vendimin e Komisionit Qendror të Ankimit dhe i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me Vendimit Nr. 1370, datë 06.07.2020 ka vendosur shfuqizimin e shkresës nr. 155, datë 01.03.2018 të DRSSH Dibër, shfuqizimin e Vendimit nr. 103, datë 14.06.2019 të KRA pranë DRSSH Dibër, shfuqizimin e Vendimit nr. 1612, datë 18.11.2019 të KQA pranë ISSH-së dhe ka vendosur detyrimin e DRSSH Dibër dhe ISSH-së që ti lidhin P.K pensionin si punonjës i minierave nëntokë në përputhje me Ligjin 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë”, vendim i cili është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Në nenin 86 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Ankimimi. 1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel; 2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të*

Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore; 3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar.....”.

Në nenin 3 të Ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, përcaktohet se: Kushtet e përfitimit; “*Kanë të drejtë të kërkojnë pension pleqërie si punonjës të minierave, në nëntokë, punonjësit, të cilët:*

a) arrijnë moshën 55 vjeç;

b) kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, nga të cilat jo më pak se 12 vjet e 6 muaj në procese pune në miniera, në nëntokë, me përjashtim të ish-punonjësve të nëntokës që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët do të përfitojnë pension sipas këtij ligji kur të arrijnë moshën 55 vjeç dhe të kenë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, përfshirë këtu edhe periudhën e trajtimit të veçantë financiar, nga të cilat, jo më pak se 11 vjet e 6 muaj të jenë në procese pune në miniera, në nëntokë”.

Në Kapitullin III, të Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, përcaktohen rregullat dhe procedurat për verifikimin e dokumenteve për pension, në të cilën përcaktohet se: “*1. Verifikimi bëhet nga inspektorët verifikues pranë arkivës së DRSSH-së, ASHV-të ose në subjektet që janë duke kryer aktivitetet ekonomiko-financiar. 2. Objekt verifikimi janë dokumentet që vërtetojnë periudhën e sigurimit dhe pagën..... 6. Procedura e verifikimit është si vijon: - Regjistri themeltar është dokumenti i parë që verifikohet. Nëse regjistri është i parregullt, pa datë fillimi ose pa datë mbylljeje të punës ose kur regjistri themeltar nuk ekziston, verifikimi vazhdon me librin e pagave. Në qoftë se fibri i pagave ka parregullsi ose kur libri i pagave nuk ekziston, atëherë verifikimi vazhdon me: Borderotë, listëpagesat. Në mungesë të tyre, verifikimi vazhdon me*”.

Referuar në sa më sipër, vlerësohet se, DRSSH Dibër, Komisioni Rajonal i Ankimit të DRSSH Dibër dhe Komisioni Qëndror i Ankimit pranë ISSH-së, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, kanë detyrimin ligjor për të verifikuar dokumentacionin e disponueshëm sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008.

Sikurse vihet re nga parashikimet e pikës 1 të Kapitullit të III të Rregullores “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, janë inspektorët verifikues ato të cilët bëjnë shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit për llogaritjen dhe përfitimin e pensionit nga ana e kërkuesve.

Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e dërguar nga DRSSH Dibër dhe ISSH, vërtetohet se nga ana e tyre është mbajtur i njëjti qëndrim në shqyrtimin e praktikave dhe të personave të tjerë të cilët kanë pasur dublime të vjetërsisë në punë.

Konkretisht, nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është verifikuar praktika e plotë dhe vendimi i gjykatës për shtetasin B.S dhe shpjegimet e dhëna nga ISSH-ja për aplikimet e shtetasve: K.O, A.M dhe I.P.

Nga verifikimi i procedurës dhe vendimmarrjes së institucionit të DRSSH Dibër dhe nga ISSH-ja, lidhur me përfitimin e pensionit si punonjës i minierës nëntokë për shtetasin B.S, rezultoi se vendimmarrja e DRSSH Dibër, Komisionit Rajonal të Ankimit të DRSSH Dibër dhe Komisionit Qëndror të Ankimit pranë ISSH-së ka qenë e njëjtë, duke rrëzuar kërkesën e tij, pasi figuronte si i punësuar dhe në Minierën e Kromit Batër dhe në Kooperativën Bujqësore Macukull dhe duke arsyetuar se: *“Kërkuesi nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit shoqëror të parashikuara nga neni 3 i Ligjit 150/2014. Kërkuesit i verifikohen si periudhë sigurimi 35 vite e 1 muaj nga të cilat 9 vite dhe 6 muaj punë në minierë nëntokë”*.

Gjithashtu, dhe në shpjegimet e dhëna nga ISSH-ja rezultoi se pas verifikimeve të kryera nga Njësia e Inspektimit të përfitimeve pranë ISSH-së për dosjet: nr. 60, me përfitues K.O; nr. 141, me përfitues A.M dhe nr. 150, me përfitues I.P, njësia ka rekomanduar pezullimin e përfitimit pasi kanë rezultuar dublime në periudhat e punësimit, në Ndërrmarrjen e Grumbullimit Mat dhe në Minierën e Qymyrgurit Manëz në rastin e parë, dublime në periudhat e punësimit në Ndërrmarrjen e Ndërtimit Mat, SMT Mat dhe në Minierën e Qymyrgurit Manëz në rastin e dytë, dhe dublime në periudhat e punësimit në Kooperativën Bujqësore Lachruc dhe në Minierën e Qymyrgurit Krrabë në rastin e tretë.

Sa më sipër, mbështetur në Ligjin nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se P.K nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë, nga ana e DRSSH Dibër dhe ISSH-së.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Neni 7 i LMD-së⁶, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

⁶ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të Ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga ana e DRSSH Dibër dhe ISSH-së, lidhur me trajtimin e rastit të P.K. Në mungesë të trajtimit të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të P.K, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për shkak të gjendjes ekonomike dhe arsimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA